

V E N D I M
Nr. 238, datë 13.4.2001

**PËR KRITERET E DHËNIES SË LEJES PËR LOJËRAT E FATIT, KAZINOTË
DHE HIPODROMET**

*(Ndryshuar me VKM nr. 786, datë 26.11.2004; nr. 867, datë 17.12.2004; nr. 645, datë
27.9.2006)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6,13,15 dhe 24, të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. KRITERET PËR DHËNIEN E LEJES PËR LOJËRAT E FATIT

1. Sipas propozimit të Komitetit të Lojërave të Fatit, në kuptim të nenit 3 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet” *ministri përgjegjës për ekonominë* i jep lejen organizatorit, për një periudhë kohe 10- vjeçare. Për dhënie e lejes për lojërat e fatit, duhet të plotësohen këto kushte:

a) Shoqëria përkatëse të jetë regjistruar në regjistrin tregtar, në formën e shoqërisë anonime, me objekt veprimtarie zhvillimin e lojërave të fatit, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) Të deklarohen themeluesit e shoqërisë, *aksionarët*, drejtuesit dhe personeli kryesor i saj.

c) Organizatori duhet të sigurojë, në çdo lojë fati, një person drejtues e kontrollues me kualifikimin dhe përvojën e nevojshme. Për këtë qëllim, në kërkesat që paraqiten në *ministrinë përgjegjëse për ekonominë*, duhet të vërtetohet kualifikimi i tyre.

ç) Organizatori duhet të garantojë, për çdo lojë, fituesin/fituesit e lojërave të fatit. Me qëllim, krijimin e garancive për fituesit e lojërave të fatit, organizatori është i detyruar të ngurtësojë një shumë të caktuar, mënyra, forma dhe masa e së cilës, përcaktohen në lejen e dhënë organizatorit të lojës. Kjo shumë ngurtësohet në një llogari të veçantë bankare dhe zhbllokohet, vetëm me urdhër të *ministrit përgjegjës për ekonominë*, sipas propozimit të Komitetit të Lojërave të Fatit. Komiteti i propozon *ministrit përgjegjës për ekonominë* zhbllokimin e këtij fondi, vetëm, pasi ka marrë ripohimin, me shkrim, të organeve tatimore, për shlyerjen e detyrimeve nga organizatori.

d) Për pajisjet dhe teknologjinë e nevojshme për zhvillimin e lojërave, organizatori i lojërave të fatit, është i detyruar të depozitojë, në Komitetin e Lojërave të fatit, certifikatën përkatëse të lëshuar nga *Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit*.

dh) Organizatori duhet të paraqesë, në Komitetin e Lojërave të Fatit, kushtet dhe rregullat e mënyrës së funksionimit të zhvillimit të lojërave, të pasqyruara këto, në rregulloren përkatëse.

2. Organizatori i lojërave të fatit mund ta ushtrojë veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ai është i detyruar të marrë leje, nga *ministri përgjegjës për ekonominë*, për çdo filial ku do të ushtrohet veprimtaria.

**II. KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTEVE DHE PËR DHËNIEN E
LEJES PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË KAZINO**

A) Kriteret për përzgjedhjen e subjekteve

1. Përzgjedhja e subjekteve, të cilat kërkojnë leje për ushtrimin e veprimtarisë në kazino, bëhet pas një procesi përzgjedhjeje të subjekteve të paraqitura, me një konkurrim të hapur, ku të drejtën për të marrë pjesë e kanë subjektet vendase e të huaja. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

a) Faza e parë, parakualifikuese;

b) Faza e dytë, përzgjedhja e subjektit fitues.

2. Në fazën parakualifikuese, subjektet që kërkojnë të marrin pjesë në konkurrim, duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentet, origjinale apo të noterizuara, që vërtetojnë se ato janë të organizuara në formë shoqërishe apo grupime shoqërishe, me objekt veprimtarie në fushën e kazinove, si dhe aktin e themelimit të shoqërisë dhe aksionarët kryesorë zotërues të paketës kontrolluese të aksioneve të shoqërisë dhe statutin.

b) Dokumentet, origjinale apo të noterizuara, që vërtetojnë se nuk janë në proces falimentimi, likuidimi a në ndonjë proces të ngjashëm, në vendin ku kanë selinë qendrore apo në vende të tjera, ku ushtrojnë veprimtarinë.

c) Një kopje të noterizuar të lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove, nëse ka, të dhënë nga organi përkatës i vendit ku ato kanë selinë qendrore, nëse një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni i shtetit ku kanë selinë qendrore apo të vendeve të tjera ku ushtrojnë veprimtarinë në fushën e kazinove.

ç) Deklaratat për burimin e kapitalit dhe të shumave të tjera që do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove në vendin tonë.

d) Vërtetimin se nuk kanë detyrime të natyrës fiskale apo të natyrave të ngjashme, kundrejt shtetit të tyre apo shteteve të tjera ku ato ushtrojnë veprimtarinë si për shoqërinë, edhe për çdo subjekt në rast grupimi.

3. Njoftimi për konkurrimin për fazën e parë parakualifikuese të publikohet të paktën në një gazetë të huaj me qarkullim ndërkombëtar dhe në dy gazeta që botohen në vendin tonë, në dy numra radhazi, dhe duhet të përmbajë:

a) Vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumenteve parakualifikuese;

b) Zonën dhe numrin e kazinove për çdo zonë ku lejohet të ushtrohet veprimtaria e kazinosë në vendin tonë;

c) Gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;

ç) Mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;

d) Vendin, orën dhe datën e shqyrtimit të dokumenteve.

Dokumentet për fazën parakualifikuese duhet të paraqiten në tri kopje, njëra prej të cilave origjinale, në zarf të mbyllur.

4. Shoqëria, së bashku me dokumentet e fazës parakualifikuese, të paraqesë edhe autorizimin e personit, që përfaqëson shoqërinë apo grupimin, i cili ka nënshkruar dokumentet parakualifikuese, duke marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga procesi i konkurrimin.

5. Pas përfundimit të fazës së parë nisin procedurat për fazën e dytë të konkurrimin. Për këtë fazë bëhet njoftim, i cili u dërgohet të gjitha shoqërive të përzgjedhura nga faza e parë parakualifikuese, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

Njoftimi për pjesëmarrjen në fazën e dytë përmban:

a) Vendin, orën dhe datën e dorëzimit të dokumenteve;

b) Formën dhe mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;

c) Gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;

ç) Vendin, datën dhe orën e zhvillimit të procedurave të shqyrtimit të dokumenteve.

6. Subjektet të cilat kalojnë fazën e parë parakualifikuese, kanë të drejtë të vazhdojnë fazën e dytë të konkurrimin dhe për këtë fazë duhet të paraqesin edhe këto dokumente:

a) Planbiznesin për zhvillimin e veprimtarisë së kazinosë;

- b) Planzhvillimin nga pikëpamja turistike të zonës ku do të ushtrohet kjo veprimtari;
- c) Përvojën e subjektit në fushën e kazinove apo të lojërave të fatit;
- ç) Madhësinë e kapitalit.

Dokumentacioni për fazën përzgjedhëse duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të vulosur e të nënshkruar nga personi, që ka autorizimin për të përfaqësuar shoqërinë a grupimin, i cili merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga zhvillimi i procedurave të konkurrimit për pajisjen me leje për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove.

7. Përzgjedhja e subjekteve në të dyja fazat bëhet nga Komiteti i Lojërave të Fatit, për Kazinotë, i cili ka në përbërje:

- a) drejtorin e Drejtorisë së Legjislacionit
në ministrinë përgjegjëse për ekonominë kryetar;
- b) drejtorin e Drejtorisë për Zhvillimin e Zonave
Turistike në Ministrinë e Rregullimit të
Territorit dhe të Turizmit anëtar;
- c) një përfaqësues nga Drejtoria e Krimit të Organizuar
në Ministrinë e Rendit Publik anëtar;
- ç) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë anëtar;
- d) një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë anëtar;
- dh) një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë anëtar.

8. Komiteti i Lojërave të Fatit, për Kazinotë bën klasifikimin e subjekteve sipas kriterëve të vlerësimit, të përcaktuara në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Anëtarët e Komitetit i Lojërave të Fatit, për Kazinotë deklarojnë, nën përgjegjësinë e tyre, se nuk kanë lidhje apo konflikt interesash me subjektet pjesëmarrëse në konkurrim.

10. Komiteti, në përfundim, shpall listën e renditjes së pjesëmarrësve në konkurrim, duke filluar nga shoqëria a grupimi që ka marrë numrin më të madh të pikëve dhe ia paraqet ministrit përgjegjës për ekonominë për miratim.

11. Subjekti, i shpallur i pari në listën e miratuar, sipas pikës 10 të këtij vendimi, vazhdon procedurën për marrjen e lejes, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet” dhe në këtë vendim.

12. Kur subjekti i shpallur i pari në listë nuk i vazhdon procedurat për marrjen e lejes, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij fitues, skualifikohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

B) Kriteret për dhënien e lejes për kazinotë

Ministri përgjegjës për ekonominë, me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, i jep lejen organizatorit të kazinosë, të përzgjedhur sipas shkronjës “A” të këtij kapitulli, për një periudhë kohe 15-vjeçare, pasi të ketë plotësuar këto kushte:

a) Të jetë regjistruar në regjistrin tregtar si shoqëri anonime, me objekt ushtrimin vetëm të veprimtarisë së kazinove dhe të lojërave të fatit.

b) Të garantojë në çdo rast fituesit e lojërave në kazino, gjë që nënkupton se duhet të ketë ngurtësuar në një llogari të veçantë bankare një shumë prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, e cila zhbllokohet vetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë, me propozimin e Komitetit të Lojërave të Fatit, pas deklarimeve të bëra nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve nga organizatori.

c) Të deklarojë themeluesit e shoqërisë, ortakët, drejtuesit dhe personelin. Këta persona nuk duhet të kenë qenë të dënuar për vepra penale në fushën e krimit ekonomik.

ç) Të ketë personel të kualifikuar në ushtrimin e veprimtarisë së kazinove dhe të lojërave të fatit, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës, i cili dorëzohet në çastin e paraqitjes së kërkesës drejtuar Komitetit të Lojërave të Fatit.

d) Të paraqesë rregulloren përkatëse për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të lojës në kazino.

dh) Të ketë një marrëveshje paraprake të paktën me njërën nga bankat me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave.

e) Brenda 5 ditëve pune, pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, subjekti i renditur i pari nënshkruan kontratën e angazhimit, me anë të së cilës merr përsipër përmbushjen e të gjitha angazhimeve të deklaruara në ofertën e tij, si dhe angazhimin për vazhdimin e procedurave të mëtejshme, deri në dhënien e kësaj lejeje. Refuzimi i nënshkrimit të kësaj kontrate ose moszbatimi i saj përbën shkak për skualifikimin e subjektit të renditur i pari dhe vazhdimin e procedurave të mësipërme me subjektin pasardhës apo për revokimin e lejes së dhënë.

III KRITERET PËR DHËNIEN E LEJES PËR HIPODROMET

1. Sipas propozimit të Komitetit të Lojërave të Fatit, ministri përgjegjës për ekonominë i jep lejen organizatorit të hipodromit, për një periudhë kohe 15-vjeçare. Për dhënien e lejes për hipodrom, duhet të plotësohen këto kushte :

a) Shoqëria duhet të regjistrohet në regjistrin tregtar, në formën e shoqërisë anonime. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë duhet të jetë, vetëm veprimtaria e hipodromit dhe e lojërave të fatit.

b) Organizatori duhet të garantojë, në çdo rast, fituesit. Për këtë qëllim, ai duhet të ngurtësojë një shumë prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion) lekësh, për garantimin në çdo rast, të fituesve. Kjo shumë ngurtësohet në një llogari të veçantë bankare dhe zhblllokohet vetëm, me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë, sipas propozimit të Komitetit të Lojërave të fatit. Komiteti i propozon ministrit përgjegjës për ekonominë zhblllokimin e këtij fondi, vetëm pasi ka marrë ripohimin, me shkrim, të organeve tatimore, për shlyerjen nga organizatori.

c) Të deklarohen themeluesit e shoqërisë, ortakët, drejtuesit dhe personeli.

ç) Organizatori duhet të sigurojë personel të kualifikuar në fushën e hipodromeve. Për këtë qëllim, organizatori duhet ta vërtetojë një fakt të tillë, në kërkesën drejtuar Komitetit të Lojërave të Fatit.

2. Organizatori duhet të paraqesë, në Komitetin e Lojërave të Fatit, kushtet dhe rregullat e mënyrës së funksionimit të lojës në hipodrom, duke depozituar në këtë rast, rregulloret përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Tabela nr.1

Tabela e vlerësimit

(Shtuar me VKM nr. 786, datë 26.11.2004)

Kriteret e vlerësimit	Pikët e vlerësimit Totali 100 pikë
1. Planbiznesin për zhvillimin e veprimtarisë në kazinotë ku aplikohet	10
2. Planzhvillimin nga pikëpamja turistike e zonës ku do të ushtrohet kjo veprimtari	40
3. Përvoja e subjektit në fushën e kazinove apo të lojërave të fatit	30

4. Madhësia e kapitalit në lekë	
30 000 000-1 000 000 000	8
Mbi 1 000 000 000	12